

VENDIM
Nr. 653, datë 14.9.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 584, DATË 28.8.2003,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, e 25, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun III, “Përgatitja e projektaktit”, të rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Projektakti i dërguar për mendim duhet të shoqërohet me relacionin shpjegues me të gjitha elementet e tij, si dhe çdo dokument tjetër, sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je.

SHTOJCA 1

**TABELA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE NË FUNKSION TË HARTIMIT TË
RAPORTIT PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK**

Emërtimi i ligjit	Ligji është subjekt i konsultimit publik (Nëse jo, poe) (Neni 4, pika 1)	Koordinatori për konsultimin publik (Neni 10)	Forma e njoftimit (Neni 11, pika 1)	Palët e përfshira në konsultim (Neni 8)	Forma e konsultimit (marrja e komenteve dhe rekomandimeve) (Neni 11, pika 2)	Afati i dorëzimit të komenteve dhe rekomandimeve (Neni 15)	A ka patur zgjatje/ përsëritje (Neni 16)	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve (Neni 19)	Raporti për transparencë në procesin e vendimmarrjes (Neni 20)	Shqyrtimi i ankesave, nëse ka (Neni 21)

a) Në rastin e projekteve në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, projektakti duhet të shoqërohet me tabelat e përputhshmërisë dhe me aktin ligjor të Bashkimit Evropian, i cili synohet të përafrohet, i përkthyer në gjuhën shqipe.

b) Në rastin e projekteve që duhet të konsultohen me publikun, relacioni duhet të shoqërohet me të dhënat për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, sipas formatit në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Shkronja “ë”, e pikës 19, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit, shpjegime në lidhje me identifikimin e grupeve të interesit, pjesëmarrës në konsultim, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, çështjet e diskutuara dhe opinionet e shprehura nga grupet e interesit, si dhe reflektimin ose jo në projektakt të opinionëve të grupeve të interesit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi